**UP1: 03-11**
**23.01.2025**
**Shkup**

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 92, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4793/1 datë 19.11.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-245/8 datë 22.01.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 2-të mbajtur më 21.01.2025, miratoi si vijon:

**Aktvendim**
**për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive (SHTR) SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP, për shkeljen e kryer të nenit 92, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit të tij programor, më 4 nëntor 2024, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4793/1 datë 19.11.2024, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. DETYROHET SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP, që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, veproj sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencis për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

**A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV ka kompetenca të kryen mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga spekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë – vërejtje pubike në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 92, параграфи (1) të ЛСХМААВ, Схољëритё Трегтаре Радиодифузиве љё трансметојнё схёрбиме програморе телевизиве детsрохен гјатё дитёс тё трансметојнё сё паку 30% програм тё кријуар буримор си вепра аудио осе аудиовизуеле маљедонасе, ндёрса схёрбими публик трансметуес сё паку 40%.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 19 nëntor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim), nga ku konstatoi se më 4 nëntor 2024, shërbimi programor televiziv i SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase.

Пикëрисхт, нга мбикëљырја ëсхтë констатуар се më 4 nëntor 2024, shërbimi programor televiziv i Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP, ka transmetuar 4 orë 9 minuta dhe 34 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që është 21.91% nga totali i programit të transmetuar gjatë ditës që hyn në llogaritjen për program të krijuar burimor (18 orë 59 minuta dhe 6 sekonda). Minimumi Ligjor prej 30% për transmetim të programit të krijuar burimor gjatë një dite, në lidhje me transmetimin në total më 4 nëntor që hyn në llogaritjen për program të krijuar burimor (18:59:06),

është 5 orë 41 minuta dhe 43 sekonda. Shërbimi programor televiziv i Shoqëris Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive SPEKTRA, komuna Labunishtë SHPKNJP, ka transmetuar për 1 orë 32 minuta dhe 9 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase.

Схкелја нга пика 1 е кётиј Актвендими, ёсхтё спецификуар нё Рапортин ме схкрим пёр мбикёљѕрје тё крѕер програморе арк.нр.10-4793/1 датё 19.11.2024, љё ёсхтё пјесё пёрбёрёсе е кётиј Актвендими си Схтојцё нр.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP, më 21.11.2024, ka dërguar Shkresë ark.nr.10-4793/2 datë 21.11.2024, me të cilin i dorëzoj dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4793/1 datë 19.11.2024, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoj deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi me datë 25.11.2024. Në afatin e parashikuar, SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 21.01.2025, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim konkludoi që SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim siaps aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4793/1 datë 19.11.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 2-të mbajtur më 21.01.2025, dhe Konkluzionin ark.nr.02-245/8 datë 22.01.2025, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmërohet SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi.

Në pajtim me nenin 24, paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për fillimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativa paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

**Shtojcë (1):**

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4793/1 datë 19.11.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike**
**Audio dhe Audiovizuele**
**Kryetari i Këshillit,**
**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë të paraqesë padi për fillimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.